

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Delushe Halimi, e me procesmbajtësen Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditëses Xh.R. nga Komuna S., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti i Mirëqenies Sociale) - DMS në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse, më dt.17.05.2016 merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Xh.R. nga Komuna S., si e bazuar. Anulohet aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-DMS në Prishtinë me numër nr.502, i dt.14.08.2013, si dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesorë në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të dy palëve ndërgjyqëse, të thirrura në mënyrë të rregullt.

Paditësja Xh.R. , në padinë e ushtruar më datë 19.10.2013, ka kërkuar nga gjykata, që të anulon aktvendimin e të paditurës, me nr 502 të dt.14.08.2013, me arsyetim se e paditura gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka refuzuar si të pa bazuar, ankesën e dt.05.08.2013.

E paditura, me përgjegjen në padi të datës 17.11.2014, ka deklaruar se i propozon gjykatës që ta refuzon si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, vendimin e të paditurës të datës 14.08.2013, ta lenë në fuqi si vendim i drejtë i bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesorë të dt.17.05.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi 502 të dt. 14.08.2013, si dhe bëhet shiqimi në dokumentacionin mjeksorë të paditësit i cili gjendet si provë në shkresat e lëndës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se: "Komisioni për shqyrtimin e ankesave i shkallës së dytë, pasi bëri shqyrtimin e të gjitha fakteve relevante dhe sipas dokumentacionit gjegjësisht formularit të verifikimit të gjendjes faktike të familjes në teren me dt.28.06.2013, i cili ishte i drejtë dhe real, është konstatuar se njëri nga antarët e familjes së kërkueses e ka penguar verifikimin e gjendjes dhe nuk ka lejuar të hyjnë brenda komisionin për të vizituar gjendjen faktike në teren, prandaj edhe ju është ndërprerë realizimi i ndihmës sociale, për kategorinë e parë.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk e ka provuar me asnjë provë të vetme në përgjigje në padi, e as në seancën e shqyrtimit kryesorë, se ka bërë verifikimin e gjendjes faktike te paditësja me dt.28.06.2013, datë kjo e konstatuar në arsyetimin e aktvendimit kontestues, me ç'rast edhe i ka refuzuar ankesën e dt.05.08.2013, si të pa bazuar.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1355/2013 dt.17.05.2016

Procesmbajtësja
Nazmije Beka

G j y q t a r j a
Delushe Halimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.